

## “KASÎDE-I BURDE” NË GJUHËN SHQIPE

### Hyrje

Njëra ndër poemat më të mira, në mos më e mira, që i është kushtuar ndonjëherë Pejgamberit Muhamed a.s., pa dyshim, është “*Kasîde-i Burde*” e Imam *Busîrî*-ut. Kjo *kaside*<sup>(1)</sup>, më vonë, ka shërbyer si model dhe frymëzim për shumë autorë, të cilët i kanë thurur lavde Pejgamberit a.s. dhe kanë shprehur dashurinë e respektin për të. Ndonëse janë shkruar shumë kaside të tjera sipas modelit të saj dhe të tilla që i kanë përngjarë asaj, asnjëra prej tyre nuk ka arritur në nivelin, e aq më pak t’ia ketë tejkualuar “*Burdesë*”<sup>(2)</sup>.

Për këtë arsye, mendohet se “*Kasîde-i Burde*” është poema më e përhapur e mësuar përmendsh në të gjithë botën<sup>(3)</sup>. Dhe, vërtet, ajo pothuajse u bë himn i të gjithëve, himn i bukurisë dhe i shprehjes së bukur, himn i devotshmërisë, himn i ringjalljes shpirtërore dhe morale, me përmbajtje të lartësuar... Si e tillë, ashtu e pranuar dhe e përvetësuar, – siç edhe vetë poeti kishte dëshiruar, ajo ka pasur rolin e saj dhe ka ushtruar ndikim të vërtetë<sup>(4)</sup>.

---

<sup>1</sup> Kasideja – është formë poetike nga më të prodhuarat në letërsinë e divanit. Vetë emri i saj tregon që ajo është poezi qëllimore. Prandaj, varësisht nga qëllimi që ka pasur poeti edhe kasideja merr emrin përkatës. Kasidetë që kanë tematikë lavdërimin për Zotin, quhen “*munâxhât*”, kurse kasidetë lavdëruese për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin a.s. quhen “*nat*”. Kasideja me të cilën poeti ka lavdëruar apo përgëzuar personin që i kushtohet ajo quhet “*med’hije*”, ndërsa kasideja që përmban vargje elegjike për vdekjen e dikujt quhet “*mersije*”. Kasideja përbwhet prej pesëmbëdhjetë deri në njëqind bejte. Më hollësisht, shih: Agâh Sirri Levend, *Türk Edebiyatı Tarihi*, cild I, baski 2, Ankara, 1984, f. 101.

<sup>2</sup> Dr. Ahmed ‘Umer Hâshim, *Burdeh el-mediha el-mubâreke*, Kajro, 1995, f. 7.

<sup>3</sup> Abdal Hakim Murad, *Pjesništvo u pohvalu Poslanika*, (s’engleskog: Enes Karić), në përmbledhjen: Šerefudin Ebu Abdullah Muhammed bin Se’id Busiri, *Kaside-i Burda* (prijevod na bosanski), përgatiti: Abdul Hakim Murad dhe Enes Karić, Sarajevë, 2008, f. 10.

<sup>4</sup> Kasim Dobrača, *Kasidei Burdei Bosnevi*, në: “*Anali Gazi Husrev-begove*

Për më tepër, “*Kasîde-i Burde*”, ose një pjesë e saj, në dallim nga poemat e tjera, është skalitur e shkruar në shumë monumente islame, e madje edhe nëpër dokumente të ndryshme (f.v. vakëfnâme etj.) gjithandej botës islame<sup>5</sup>. Ekzistojnë dhjetëra komente që i janë bërë kësaj poeme, nga dijetarë të shquar në kohë dhe në vende të ndryshme. Ndër më të njohurit përmenden komenti i Ümer el-Harbûtit me titull “*Asîdetu ‘sh-shehde sherh Kasîdetu ‘l-Burde*”, pastaj komenti i Hâlid Abdullâh el-Ezheri “*Ez-Zubdetu fî sherh Kasîdetu ‘l-Burde*”, kopje të të cilëve kemi gjetur në shumë biblioteka private të ulemave tona të mëhershme etj. Bibliografi i shquar turk, Haxhi Kallfa, përmend dyzet komentime të “*Burdesë*” vetëm në gjuhën arabe.<sup>6</sup>

Ndërkaq, për sa i përket përkthimit në gjuhë të tjera, “*Kasîde-i Burde*” ka ardhur në shumë gjuhë të botës, si p.sh.: në gjuhën turke nga Kemâl Pashâzâde (vd. 1534), në gjuhën perse nga Abdurrahmân Xhâmî (vd. 1492), pastaj në gjuhën urdu, në gjuhën malaje, në gjuhë të ndryshme të popujve afrikanë, në gjuhën kineze (më 1890), në gjuhën boshnjake, në gjuhën shqipe etj., që të gjitha këto me shkronja arabe. Në gjuhën turke e ka përkthyer dhe e ka komentuar këtë kaside edhe shqiptari i shquar, politikani, ideologu, diplomati, letrari, rilindasi dhe aktivisti i çështjes shqiptare, Abidin pasha Dino nga Preveza (1843-1906), me titull “*Tercüme ve Şerh-i Kasîde-i Bürde*”,<sup>7</sup> (Stamboll 1882), që konsiderohet si një nga përkthimet më të mira të kësaj kasideje në këtë gjuhë<sup>8</sup>.

Në gjuhët perëndimore, përkthimi i “*Burdesë*” fillon në vitin 1771 në versionin latin të Johannes Jurij. Përkthimi i parë në gjuhën gjermane ka dalë në vitin 1824, kurse vepra “*La Burdha du*

bibliotekë”, lib. IV, Sarajevë 1976, f. 11.

<sup>5</sup> Enes Karić, Qasîdatu l-Burdah u Bosni, në: “Znakovi Vremena”, vol. 13, br. 47, Sarajevë, 2010, f. 156.

<sup>6</sup> Haxhi Halifa, Mustafâ b. Abdullâh Kâtib Çelebi, Keshf edh-dhunûn ‘an esâmi ‘l-kutub ve ‘l-funûn, II, Stamboll, 1943, f. 1331-1332.

<sup>7</sup> Më gjerësisht, shih: Hasan Kaleshi, Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale, në: “Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huajt”, nr. 2, Prishtinë 1976, f. 188-190.

<sup>8</sup> İslâm Ansiklopedisi, zëri: “Kasidetü’l-Bürde”, i shkruar nga Mahmut Kaya, vëll: 24; faqe: 569, Stamboll 2001.

*Cheikh al-Bousiri*" (Paris 1894) e Rene Bassetit<sup>9</sup> nuk është e para, por sigurisht versioni poetik më i suksesshëm i kësaj kasideje në gjuhën frënge. Përkthimi i parë në gjuhën angleze është i vitit 1881 nga Jamesa Redhouse.<sup>10</sup>

Kjo kaside edhe ndër ne ka qenë shumë e njohur. Ajo është mësuar si tekst i veçantë në medresetë tona. Nxënësit dhe studentët e shkollave tona islame, pothuajse të gjithë, e kanë ditur përmendësh nëse jo të tërën, pjesë të saj gjithsesi po. Për më tepër, studentëve që ishin dalluar në këndimin, leximin, shpjegimin dhe komentimin e "*Burdesë*", u jepeshin diploma/ixhazetnâme të veçanta për këto arritje.<sup>11</sup>

Kjo ka bërë që shumë kaside dhe mevlude të autorëve tanë shqiptarë, kur kanë filluar krijimet e tyre, në fillim kanë vënë edhe shënimin shpjegues se cila kaside, ose cili mevlud, rimon sipas "*veznit*"<sup>12</sup> të "*Kasîde-i Burdesë*", gjë që flet për ndikimin e madh që ka pasur kjo poemë në krijimet e autorëve tanë të këtyre zhanreve. Por edhe në rrafshin eufonik, mund të thuhet, se ajo është shndërruar në një model për vepra poetike.

Në të gjitha bibliotekat, që ruajnë dorëshkrime në gjuhët orientale dhe me përmbajtje islame, gjenden kopje në dorëshkrim të kësaj kasideje, ndërsa si botime numri i tyre është shumë më i madh<sup>13</sup>.

<sup>9</sup> Rene Basset (1855-1924) orientalist francez. Ka qenë anëtar i Akademisë Arabe. Ka studiuar në Ecole Nationale de Langues orientales Vivantes në Paris. Në vitin 1882, është zgjedhur profesor në shkollën e lartë në Algjeri, më pas u bë edhe drejtues i asaj shkolle. Ka qenë anëtar i shumë institucioneve shkencore. Në vitin 1910 ka udhëhequr kongresin e orientalistëve në Algjer. Është autor i disa veprave në arabishte dhe i shumë studimeve në frëngjisht në fushën e studimeve orientale. (Shih: Abdurrahman Bedevî, Leksikon i orientalistëve, / përktheu dhe plotësoi: Isa Memishi, Shkup, 2015, f. 100).

<sup>10</sup> Šerefudin Ebu Abdullah Muhammed bin Se'îd Busiri, *Kaside-i Burda* (prijevod na bosanski), përgatiti: Abdul Hakim Murad dhe Enes Karić, Sarajevë, 2008, f. 11.

<sup>11</sup> Një ixhazetnâme të tillë, myderrizi i medresesë "*Mehmet Pasha*" në Prizren, hfz. Abdylaziz Hivzi efendi u me datën 5 safer 1325/20 mars 1907 ia kishte lëshuar studentit të tij Haxhi Iljas ef. Shasivarit nga Prishtina. Një kopje e saj gjendet në bibliotekën tonë personale.

<sup>12</sup> Sipas formës metrike dhe masës së poezisë.

<sup>13</sup> Në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë ruhen dy komente në dorëshkrim në gjuhën osmane të "*Kasîde-i Burdesë*" (Titulli Sherhi kaside Burde [dorëshkrim]

Kjo poemë ka qenë shumë e njohur te ne dhe këtë e dëshmon edhe fakti se ajo që në fillim të shek. XIX është përkthyer në gjuhën shqipe nga një poet i shquar i yni – Muhamet Çami (1784-1844)<sup>14</sup>.

Për aq sa dimë, ky është përkthimi i parë i kësaj kasideje në gjuhën shqipe, ndonëse deri më sot ka mbetur në dorëshkrim dhe përveç përmendjes, nuk ka njohur ndonjë analizë e kujdes të veçantë.

Një bashkëkombas tjetër i mëvonshëm i M. Çamit, hafëz Abdullah Sëmlaku, e ka përkthyer “*Burdenë*” si të tërë, e ka pajisur me shënime dhe e ka botuar në Korçë në vitin 1924.

Sigurisht që M. Çami dhe A. Sëmlaku nuk janë të vetmit që do ta kenë përkthyer “*Kasîde-i Burdenë*”. Midis tyre do të ketë edhe autorë të tjerë që e kanë bërë një punë të tillë.

Në vitin 1853/54 (1270 H), edhe një çam tjetër nga Konispoli, mulla Abdullah Sulejman Alihoxha e kishte përkthyer në shqip “*Burdenë*”<sup>15</sup>. Edhe ky përkthim nuk ka pasur vëmendjen e duhur

---

Botuar s.l., s.a. Të dhëna fizike 362 f.; 21 cm. Klasifikimi dhjetor 821.411.21 - 1.09 821.411.21 - 97.09 091 =512.161 dhe Sherhi Kaside Burde [dorëshkrim] Të dhëna fizike 294 f.; 19 cm. Klasifikimi dhjetor 821.411.21 - 1.09 821.411.21-97.09 091=512.161). Kurse në Bibliotekën e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës ruhet komenti i bërë nga Hâlid b. Abdullâh el-Ezherî, i kopjuar nga Abdulkadëri, i biri i Abdurrahimit, në vitin 1747 (dorëshkrimi me Sig. nr. D. A. 0364).

<sup>14</sup> Muhamet Kyçyku-Çami (1784 - 1844), shërben si pikë transitive ndërmjet versetit klasik të bejtexhinjve dhe poezisë së Rilindjes së gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Muhamet Çami ishte nga Konispoli, Jugu i Shqipërisë së sotme. Ai studioi teologjinë islame për njëmbëdhjete vjet në Kajro. Pas kthimit në fshatin e tij të lindjes ai shërbeu si hoxhë dhe vdiq më 1844 (1260 H.). Tregimet e tij të gjata në vargje “Erveheja” dhe “Jusufi dhe Zelihaja” janë të parat poema laike në letërsinë shqipe. Të dyja veprat poetizojnë idetë e moralit islam. Ka shkruar edhe disa vjersha të gjata me temë laike me karakter moral, si “Bekriu”, “Gurbetlitë”, “Zaptimi i Misolongjit” etj. Ka botuar të përkthyer edhe vepra të tjera. (Shih: Fjalori enciklopedik shqiptar, zëri: “Çami (Kyçyku) Muhamet”, i shkruar nga Jorgo Bulo, vëll. I, Tiranë, 2008, f. 375.) Shih edhe: Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu, Tiranë - Pejë: Dukagjini, 1997, f. 79-81.

<sup>15</sup> Abdullah Sulejman Alihoxha-Konispoli (1795-1865). Ndoqi shembullin e Muhamet Çamit. Ka përkthyer disa vepra nga gjuha arabe, turke dhe persiane. Ka lënë një numër të mirë vjershash origjinale dhe të përkthyer nga këto gjuhë. Është autor edhe i një mevludi në gjuhën shqipe me grafi arabe (rreth vitit 1831) “që dallohet ndërmjet të gjithë mevludeve të tjerë të shkruar prej çamëve”. Më gjerësisht: Ibrahim D. Hoxha, Vjershetarë të hershëm çamër, Tiranë, 2001, f. 205-244.

të studiuesve<sup>(16)</sup>.

Një pjesë të "*Burdesë*" e ka përkthyer dhe e ka botuar edhe ish-myftiu i Dibrës, Salih (Ferhat) Hoxha (1917-1995).

### Autori - rrethanat - vepra

Autori i "*Burdesë*" është Imam Sherifudîn Ebu Abdullâh Muhammed Busîrî nga Egjipti me prejardhje berbere. Ka lindur në vitin 1212. Ka qenë nxënës i mësuesit të njohur të sufizimit Ebû el-Abbâs el-Mursît. Busîrî ka qenë i arsimuar në të gjitha disiplinat e fikhut, historisë islame, hadithit dhe ekzegjzës kuranore. Në moshën trembëdhjetë vjeçare u bë hafëz i Kuranit. Ka punuar si imam dhe gjykatës në shumë qytete të Egjiptit, po ashtu edhe si administrator te ministri memaluk Zejnuddîn Jakûb ibn Zubejri, i cili ishte sponsor dhe kujdestar i tij. Rreth vendit dhe vitit të vdekjes së imam Busîrît ka mospajtime. Vdiq në Aleksandri, apo në Kajro, mbase në vitin 1297. Në Aleksandri xhamia me emrin e Busîrît dhe varri i tij gjenden përballë kompleksit të madh të xhamisë së mësuesit të tij El-Mursît. Në vitin 1863, xhaminë e vogël, por shumë të bukur, e ka rindërtuar dhe e ka zgjeruar valiu me prejardhje shqiptare, Mehmet Sait Pasha, ndërsa muret e saj janë të zbukuruara me 94 vargje të "*Burdesë*", të shkruara më llojin e shkrimit arab *nes'h-talîk*, së bashku me disa poezi të tjera të shkruara me një kaligrafi të jashtëzakonshme në gjuhën arabe dhe turke<sup>(17)</sup>.

Imam Busîrî u shqua edhe në poezi, ekskluzivisht me poezitë kushtuar Pejgamberit a.s. Më e njohura prej tyre, pa dyshim, mbetet "*Kasîde-i Burde*", emri i plotë i së cilës është

<sup>16</sup> E përmendin: Osman Myderrizi, Letërsia shqipe me alfabetin arab, në "Buletin për Shkencat Shoqërore", 2, Tiranë, 1955, f. 152; Dhimitër S. Shuteriqi, Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Prishtinë, 1978, f. 200 dhe Robert Elsie, Dictionary of Albanian literature, Copyright 1986, f. 80. Por të dhëna më të plota bibliografike për këtë autor gjejmë te Ibrahim D. Hoxha, i cili edhe e ka transkriptuar "*Kasîde-i Burden*", e përkthyer nga Abdullah Konsipoli. Shih: Ibrahim D. Hoxha, Vjershëtarë të hershëm çamër..., po aty, f. 205-244.

<sup>17</sup> Abdal Hakim Murad, Pjesništvo u pohvalu Poslanika, (s'engleskog: Enes Karić), në përmbledhjen: Šerefudin Ebu Abdullah Muhammed bin Se'id Busiri, Kaside-i Burda (prijevod na bosanski), përgatiti: Abdul Hakim Murad dhe Enes Karić, Sarajevë, 2008, f. 8.

“El-Kevâkib ed-durrijje fî med’hi hajri ‘l-berrijje” (“Kurora e yjve ndriçues për lavd të njeriut më të madh”)<sup>(18)</sup>. Njihet edhe me emrin “Kasîde-i bur’e” (“Poema e shërimit”). Te ne njihet si “Kasîde-i Burde”, ose vetëm “Burde”, siç e kemi përdorur edhe në këtë vështrim.

Në të vërtetë, rreth titullit të kësaj poeme ka disa mendime. I pari thotë se “Burde” ka qenë pseudonimi i autorit, i cili në mënyrë metaforike ka dashur të tregojë se u bashkohet radhëve të autorëve që kanë shkruar për Pejgamberin a.s. Mendimi i dytë thotë se Busîrî ka dashur të krahasojë veten e tij me poetin klasik *Ka’b b. Zuhejrin*, i cili kishte shkruar një kaside me të njëjtin titull. Mendimi tjetër thotë se autori ynë i sëmure, pasi e kishte përfunduar poemën e tij, e kishte parë në ëndërr Muhamedin a.s., i cili si shpërblim mbi supet e tij ia kishte hedhur xhyben, e cila në gjuhën arabe quhet “burde”, e nga këtu edhe i vuri titullin “Kasîdeja e Burdesë” (“Poema e Xhybes”). Po ashtu, thuhet se atë natë që poeti kishte mbaruar së shkruari kasidenë e tij, kishte parë në ëndërr se si Muhamedi a.s., e kishte fërkuar me duart e tij fisnike dhe se ai qe shëruar nga sëmundja që kishte vuajtur shumë dhe gjatë. *Shërimit* në gjuhën arabe i thonë “bur’a” dhe nga këtu kjo poemë është bërë e njohur si “Kasîde-i Bur’a” (“Poema e shërimit”)<sup>(19)</sup>.

Sido që të jetë, koha kur ka lindur kjo poemë, sipas K. Dobraçës<sup>(20)</sup>, në të vërtetë, ka qenë kohë kur bota islame, veçanërisht ajo në hapësirën e Lindjes së Afërme, pra në qendrën kulturore të popujve myslimanë, vazhdonte të vuante dhe të dridhej nga të rënat e forta, të cilat ua kishin shkaktuar mongolët nga Lindja (rënia dhe rrënimi i Bagdadit në vitin 1258) dhe para tyre luftrat e kryqëzatave nga Perëndimi. Krahas këtyre, asokohe sundonin

<sup>18</sup> İslâm Ansiklopedisi (Türkiye Diyanet Vakfı *İslam Ansiklopedisi*), zëri: “Kasîdetü’l-Bürde”, i shkruar nga Mahmut Kaya, vëll: 24; faqe: 569, Stamboll 2001; Ahmed Abdut-tevvâb ‘Avad, *El-Burdetu li ‘l-Busîrî*, Kajro, 1996, f. 10.

<sup>19</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, Korçë, 1924, f. 11; Kasim Dobrača, *Kasidei Burdei Bosnevi...*, po aty, f. 12; Ahmed Abdut-tevvâb ‘Avad, *El-Burdetu li ‘l-Busîrî...*, po aty, f. 16.

<sup>20</sup> Se sa të forta kanë qenë goditjet dhe çfarë pasojash kanë pasur për jetën dhe ekzistencën e botës islame dhe të kulturës së saj, mbase më së miri na e tregojnë fjalët e orientalistit të njohur Carl Brockelmann, i cili thotë se bota islame, madje as sot nuk është shëruar nga ato të rëna. (Shih: *Geschichte der arabischen Literatur*, II-3, cituar sipas: Kasim Dobrača, *Kasidei Burdei Bosnevi*, po aty, f. 10).

murtaja dhe uria. (Vetë poeti, sikurse e thamë, ka qenë i sëmurë rëndë nga paraliza). Asokohe, bota islame, veçanërisht populli arab, ishte i thyer jo vetëm materialisht dhe politikisht, por edhe shpirtërisht e moralisht.

Në rrethana dhe në një gjendje të tillë, kur grushtet e forta i hutojnë edhe mendjet më të forta, kur individët dhe bashkësia humbin forcën dhe zërin, kur te njeriu dhe në shoqëri gjithçka është e luhatshme, kur rendi shoqëror dhe morali janë thyer, kur dobësia shpirtërore dhe rënia gjithnjë e më shumë kërcënojnë, shpirti i ndjeshëm i poetit Busîrî dhimbshëm vajtonte dhe lot të përgjakur lëshonte mbi të gjitha ato që asokohe ngjanin në botën islame. Në ato rrethana, kur dëshpërimi kishte përfshirë shpirtat më të fortë, poeti, me lot e dhimbje, shpreson dhe kërkon ringjallje dhe vitalizim të forcave shpirtërore, duke pirë nga burimi islam në Medinë, duke e kujtuar e përmendur Pejgamberin e Zotit, Muhamedin a.s., duke e ripërtërirë frymëzimin e tij në zemrat e thyera dhe të ngrira të besimtarëve, që duke e marrë shembull Pejgamberin a.s. t'u ikin sëmundjeve dhe humnerës. Për këtë shkak, ai, që në fillim, nën dhimbjen e ngërçit, i referohet erës së Medinës dhe kërkon freski nga era që po fryn nga ana e saj dhe nga i madhi medinas-Muhamedi a.s., i cili po në Medinë prehet<sup>(21)</sup>. Prandaj edhe poemën autori e nis me vargjet, që në përkthim të A. Sëmlakut, thonë:

*“Shokët e Selemit(22) pos kujton tinë  
më gjak të përzjerë lotët gjith të vinë!  
apo të fryn era si ngaj Qazimeja(23)  
Apo shkrepëtimën sheh nga Medineja”(24).*

Këto vargje dhe mbase edhe rrethanat shoqërore politike në të cilat jetoi A. Sëmlaku, , të ngjashme me ato kur u shkrua *“Kasîde-i Burde”* (ç’është e drejta, edhe sot bota islame në përgjithësi dhe ajo

<sup>21</sup> Më gjerësisht për këtë shih: H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, Korçë, 1924, f. 26-30; Kasim Dobrača, *Kasidei Burdei Bosnevi*, po aty, f. 10.

<sup>22</sup> Selem (Dhî-Selem) – vend afër Medinws.

<sup>23</sup> Qazimeja (Kâdhime-ja) –vend nga i cili Pejgamberi a.s. kundronte-vështronte në mes të Mekës e Medinës; një rrugë për në Mekë.

<sup>24</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, po aty, f. 12.

arabe në veçanti nuk po kalon ditët më të mira), – e shtyn hfz. A. Sëmlakun, si poet që ishte, të bënte një lutje të ngjashme, ku thotë:

*“Ti moj er e Jugës që vjen nga Meqeja  
Ngaj vend i uruar që ndodhet Qabeja,  
Në të rëntë udha si nga Medineja  
Atje është Resuli dhe gjith Sahabeja.  
Habibit prej meje një Selam i shpjerë  
Edhe lutju tinë mua mos më lerë,  
Me gjynah të shumta un jam një i mjerë  
Nga vala e detit i thuaj të më nxierë!”(25)*

Sidoqoftë, *“Kasîde-i Burde”* numëron 161 bejte (dyvargësh). Në fillim, 12 vargjet e para janë hyrje në poezi (*matla'*) dhe në të shtjellohen gjithsej dhjetë tema, si më poshtë:

1. Për dashurinë ndaj Pejgamberit a.s. (1-12);
2. Për “nefsi emmaren” – shpirtin e keq që e tërheq njeriun në punë të liga dhe si të kontrollohet dhe menaxhohet ky nefsi (13-28);
3. Për lavdinë e Pejgamberit a.s. (29-58);
4. Për lindjen e Pejgamberit a.s. dhe ç’u pikas (59-72);
5. Për të thirrurit e Pejgamberit a.s. në fenë islame – muxhizet (73-88);
6. Për nderimin për Kuranin (89-105);
7. Për Miraxhin e Pejgamberit a.s. (105-118);
8. Për betejat e Pejgamberit a.s. (119-140);
9. Për të kërkuarit falje nga Zoti dhe shefat nga Pejgamberi a.s. (141-152);
10. Lutje Pejgamberit a.s (153-161)<sup>(26)</sup>.

Kasideja është e thurur edhe me elemente dhe mendime të tesavufit, kështu që disa e konsiderojnë kaside sufiste. Me kohë, rreth kësaj kasideje filluan të thureshin shumë legjenda<sup>(27)</sup> dhe

<sup>25</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, po aty, f. 34.

<sup>26</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, po aty, në parathënie, I.

<sup>27</sup> Një legjendë të tillë e përmend edhe H. A. Sëmlaku, shih: *Pesë kaside*, po aty, f. 11.

për këtë arsye, ajo filloi të humbte ndikimin dhe qëllimin e vet të vërtetë fetaro-moralizues dhe iluminist islam<sup>(28)</sup>.

### Përkthyesi

Hafëz Abdullah Sëmlaku (1892-1960) u lind dhe u rrit në një familje intelektuale në Bilisht, në vitin 1892. Babai i tij, Salih Hulusi efendiu ka shërbyer për 30 vjet si mësues i shkollës së mesme të ulët (rushdije), në disa qytete të Shqipërisë, si në Bilisht, Durrës, Ersekë, Krujë etj. Po ashtu, ai ka dhënë mësim edhe në Prilep, Allosojë, Ankorë etj.

Mësimet e para fillore dhe të mesme, të asaj kohe, Abdullahu i mori nga i ati, pastaj i vazhdoi në Medresenë e Prilepit, ku edhe ka shërbyer i ati, si mësues ruzhdie. Në vitin 1910, u pranua në degën Ilahijat të Universitetit të Stambollit, ku edhe u diplomua.

Në vitin 1921 u kthye në atdhe dhe me propozim të Ministrisë së Arsimit u emërua mësues në fshatin Kuç dhe Belorta të rrethit të Korçës. Në këtë detyrë punoi vetëm tre vjet, pastaj dha dorëheqjen, me qëllim që të ishte i lirë për t'u marrë me veprimtari fetare dhe botuese.

Në vitin 1934, me dekret të Këshillit të Përherhëm të Komunitetit Mysliman shqiptar, emërohet inspektor për të gjitha shkollat fetare të Shqipërisë. E përkrahu Luftën Nacionalçlirimtare, por ishte kundër komunizmit dhe vendosjes së diktaturës, për çka edhe si shumë prijës të tjerë fetarë, në vitin 1946 arrestohet dhe dënohet me heqje lirie për dy vjet si sabotator i pushtetit. U lirua në vitin 1948, por po atë vit arrestohet dhe dënohet përsëri me të njëjtat motive edhe me 6 muaj të tjerë burgim.

Si rezultat i një pune të madhe këmbëngulëse e të gjatë në kohë me librin dhe botimet, H. A. Sëmlaku ia doli mbanë të përkthejë, të hartojë, të shkruajë dhe të botojë mbi 30 libra origjinalë dhe të përshtatur, të cilët ishin shumë të kërkuar dhe që u ribotuan disa herë, për të qarkulluar brenda e jashtë vendit. Disa prej tyre janë: *“Meoludi Sherif”*; *“Pesë Kaside”*; *“Hydbe me 50 këshilla fetare”*; *“Muhamedia (Jeta e Pasosur)”*; *“Bilbili I – Abetare me disa jetëshkrime”*; *“Bilbili IV – Hadithi Sherif (Fjala Profetike)”*; *“Bilbili V-Sheriati Muhamedie”*; *“Bilbili VI – Ëndërrëfenjëse”*; *“Bilbili VII – Shqiponja*

<sup>28</sup> Kasim Dobrača, Kasidei Burdei Bosnevi, po aty, f. 12.

*besëtare*"; "Bilbili VIII – Fëllëza kombëtare"; "Bilbili i ri i Hazreti Kuranit"; "Fletore Islame"; "Amexhyzi me gërma shqip"; "Tebareqe xhazi"; "Bilbili shqiptar – Dheshkronjë e Shqipërisë" etj.

Hfz. A. Sëmlaku ndërroi jetë në vitin 1960<sup>(29)</sup>.

### **"Kasîde-i Burde" në shqip**

Sikurse u tha, në mesin e veprave të përkthyerë dhe të botuara nga hfz. A. Sëmlaku, është edhe përmbledhja "Pesë Kaside". Në të vërtetë, në këtë përmbledhje, janë përfshirë këto kaside, sipas kësaj renditjeje:

1. Kasideja Emali;<sup>(30)</sup>
2. Kasideja e Ebu Hanifesë;<sup>(31)</sup>
3. Kasideja e Imam Busirit;
4. Kasideja e Ebu Beqirit;<sup>(32)</sup>
5. Kasideja e Imam Aliut.<sup>(33)</sup>

Po ashtu, në fund të kësaj përmbledhjeje, janë përfshirë edhe tri poezi të vetë hfz. Abdullah Sëmlakut.

*"Nderimin e këtyre kasideoet vetëm të nderçmit ulema edhe të diturit mund t'ja u dinë..."*, përfundon përkthyesi ynë, dhe na porosit se: *"Çdo mysliman që do të kuptojë mirë njëtimin e Zotit edhe madhërinë e të madhit tonë Pejgamberit, këtë libër le ta këndojë, dhe me mejtim të plotë le ta gjykojë (...)"*<sup>(34)</sup>.

Kjo vepër, sipas shënimeve të vëna aty, u botua në muajin Ramadan të vitit 1342, që korrespondon me vitin 1924, në

---

<sup>29</sup> Më gjerësisht: Grup autorësh, 100 personalitetet shqiptare të kulturës islame (shek. XIX-XX), Tiranë, 2012, f. 12-13; Maksim Gjina-Petrit Bezhani, Libra në gjuhën shqipe për Islamin (bibliografi), vëll. I, Stamboll, 2002.

<sup>30</sup> Kasideja "Bed-u 'l-emâli", bënë fjalë për njëtimin-Njëshmërinë e Zotit dhe për besimin që duhet të ketë një mysliman i vërtetë. E ka shkruar 'Alî b. 'Uthmân el-Ûshî el-Fargânî (vd. 575/1179).

<sup>31</sup> Kjo kaside tregon për madhësinë e Pejgamberit Muhammed a.s. dhe për muxhizet e tij. Imami Azami-Ebu Hanife (vd. 150/767), e ka shkruar këtë poezi gjatë vizitës që i ka bërë varrit të Pejgamberit a.s.

<sup>32</sup> Është lutje, dua e përgjërimit që i bëhet Zotit xh.sh., e Hazreti Ebu Bekrit r.a.

<sup>33</sup> Kaside të Hazreti Aliut r.a.; këshilla të thëna në formë vargjesh.

<sup>34</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, Pesë kaside, po aty, f. II.

shtypshkronjën dhe librarinë “Dhori Koti” të Korçës. *“Me atë ndihmë që më dha Zoti, e mbarova edhe këtë libër në muajin e nderçmë Ramazan e i dhashë funt ditën e Arefesë në xhami të shënjtë të katundit tim Sëmlak. Në të cilën xhami të vogël që vazhdojnë në të pesë kohët me xhemat që siojet e tutje zunë po vazhdojnë më tepër se një qint shpirt Muhammedanë më Teraviih e me xhemat, laudi i qoftë Zotit!”<sup>(35)</sup>*

Ç’është e vërteta, përmbledhja ka edhe një shënim hyrës, *“Dy fjalë”*, një si *parathënie* nga përkthyesi, ku shpjegohet se ç’është kasideja, pastaj kur është përkthyer kjo përmbledhje, si dhe një si *përfundim*, së bashku me listën e ndihmëtarëve për botimin e kësaj vepre dhe me *“përmirësimin e gabimeve të shtypit”*. Përmbledhja ka gjithsej 35 faqe dhe është e shkruar në gjuhën e kohës.

Vlen të theksohet se krahas përkthimit të *“Pesë kasideve”*, ka edhe shënime plotësuese të përkthyesit, që meritojnë një vështrim të veçantë.

Meqë përkthimi i *“Burdesë”* nga hfz. A. Sëmlaku është i plotë dhe i botuar me shkronja shqipe, disa pjesë të kësaj poeme i kemi përzgjedhur për t’i botuar në këtë vështrim tonin, pa bërë ndonjë ndërhyrje të theksuar a shpjegim plotësues.

Shpresojmë se jo vetëm *“Kasîde-i Burde”* e përkthyer prej hafëz Abdullah Sëmlakut, por edhe kasidet e tjera në këtë përmbledhje, do të bëhen pjesë e një vështrimi më të gjerë të studiuesve kompetentë të fushave të ndryshme dhe do të botohen, qoftë ashtu siç janë botuar në vitin 1924, qoftë të përpunuara e të plotësuara me shpjegime të hollësishme e të nevojshme.

Gjithsesi, mund të përfundohet me konstatimin se *“Kasîde-i Burde”* është një vepër e veçantë dhe me ndikim të ndjeshëm në rrjedhat tona letrare të këtij krahu tematik. Kjo gjë mund të konstatohet jo vetëm sa i përket tematikës së saj, por edhe modelit artistik dhe veçmas dimensionit të rrallë eufonik të saj. Me përkthimin e kësaj kasideje, por edhe të kasideve të tjera që u përmendën, hafëz Abdullah Sëmlaku, përveç kulturës dhe talentit të tij letrar, ka dëshmuar qartësisht edhe kapacitetin e gjuhës shqipe për të sjellë në formatin e saj gjuhësor vlera të çmuara të letërsisë botërore me përmbajtje islame.

Dhe në përfundim, po sjellim dhe një kasidë të vetë hfz. A. Sëmlakut, i cili i dëshmoi vlerat e tij si poet pikërisht sa i përket stilit dhe nivelit artistik të kësaj poeme. Ai, sipas shembullit të

<sup>35</sup> H. Abdull-llah Sëmlaku, *Pesë kaside*, po aty, f. 34.

“*Kasîde-i Burde*”, kishte shkruar edhe një poezi, të cilën e kishte përfshirë në përmbledhjen “*Pesë kaside*”. Duke u përmbajtur nga ndonjë vlerësim me të cilin mund të dëmtonim kasidenë e tij, – meqë kjo i tejkalon qëllimet, mundësitë dhe kompetencat tona, – i japim të drejtë vetes të themi se edhe sikur të ishte vetëm kjo kaside e hfz. A. Sëmlakut, do të mjaftonte për t’i bërë vend në mesin e atyre poetëve tanë që kanë shkruar kaq bukur, me kaq ndjesi, dashuri e respekt për Pejgamberin Muhamed a.s.

### ***Bibliografia***

- ‘Avad, Ahmed Abdu-t-tevvâb. *El-Burdetu li ‘l-Busîrî*, Kajro, 1996.
- Bedevî, Abdurrahman. *Leksikon i orientalistëve*, Shkup, 2015.
- Busiri, Şerefudin Ebu Abdullah Muhammed bin Se’id, *Kaside-i Burda (prijevod na bosanski)*, përgatiti: Abdul Hakim Murad dhe Enes Karić, Sarajevë, 2008.
- Dobrača, Kasim. *Kasidei Burdei Bosnevi*, në: “Anali Gazi Husrev-begove biblioteke”, lib. IV, Sarajevë 1976.
- Elsie, Robert. *Histori e letërsisë shqiptare*, përktheu nga anglishtja: Abdurrahim Myftiu, Tiranë – Pejë: Dukagjini, 1997.
- *Fjalori enciklopedik shqiptar*, zëri: “Çami (Kycyku) Muhamet”, i shkruar nga Jorgo Bullo, vëll. I, Tiranë, 2008.
- Gjina, Maksim. – Bezhani, Petrit. *Libra në gjuhën shqipe për Islamin (bibliografi)*, vëll. I, Stamboll, 2002.
- Grup autorësh, *100 personalitetet shqiptare të kulturës islame (shek. XIX-XX)*, Tiranë, 2012.
- Hâshim, Dr. Ahmed ‘Umer. *Burdeh el-medîha el-mubâreke*, Kajro, 1995.
- Hoxha, Ibrahim D.. *Vjershëtarë të hershëm çamër*, Tiranë, 2001.
- *Ëslâm Ansiklopedisi*, zëri: “*Kasîdetü’l-Bürde*”, i shkruar nga Mahmut Kaya, vëll: 24; faqe: 569, Stamboll 2001.